




REPUBLIKA E KOSOVES / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO		
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY		
Dep.	2 D/DPK	Nr. Prot.
Dep.		Br. Prot.
Dep.		Prot No.
Nr. I faq.	02	01-1383/15
Broj stranica		Date
Nr. pages		Datum
		Date 21-05-2015
PRISHTINE		



Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosova

**AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI – CORRUPTION AGENCY**

Duke u bazuar në nenin 11 paragrafi 1.1, nenin 5 paragrafi 1.5 dhe nenin 18 paragrafi 10 dhe 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korruptionit si dhe nenin 24 paragrafi 11 dhe 12 të Rregullorës së Punës të Agjencisë kundër Korruptionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korruptionit me datë 12.05.2015, nxjerr këtë:

V E N D I M

I. Mbylllet rasti me Nr. AKK-03-02-329-15 për znj. *Violeta Dema-Këshilltare Komunal* në *Komunën e Gjakovës*, për shkak se është *shmangur situata e konflikti* të interesit në ushtrimin e funksionit publik.

II. Rasti mund të rihaqet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

I. Rasti i hapur nën dyshimin e bazuar për Konflikt interesit në ushtrimin e funksionit publik, me nr. AKK-03-02-329-15, për Zyrtaren e lartë, znj.Violeta Dema-Këshilltare komunale në Komunën e Gjakovës, dhe njëkohësisht person e autorizuar në biznese privat, është trajtuar sipas procedurës së paraparë ligjore, për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik (Ligji Nr. 04/L-051).

Zyrtarja e lartë, znj.Dema fillimisht është njoftuar me një shkresë zyrtare nga Agjencia kundër Korruptionit (Z.D./01-447/15), pas të cilës ajo është kontaktuar nga zyrtarët e Agjencisë kundër Korruptionit, me ç'rast është njoftuar me situatën në të cilën ndodhet, si dhe me ndryshimet që duhet të bëjë, për të shmangur dhe për të parandaluar kështu situatën e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit të saj publik.

Zyrtarja e lartë, znj.Dema, është deklaruar se do t'i bëjë ndryshimet e kërkua e Agjencionin për regjistrimin e Bizneseve të Kosovës.

Ndërkohë, ajo, në Agjencinë kundër Korruptionit, së pari ka dërguar shkresën zyrtare nga Agjensioni për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë (ARBK) "Informata mbi biznesin" (DPK/DPKI-03-02-1205/15) në të cilën shihet se znj.Dema ka hequr dorë nga funksioni i personit të autorizuar të biznesi "Top Radio Company" sh.p.k.

Ndërsa, më pastaj ka dërguar edhe shkresën tjeter zyrtare, po ashtu nga ARBK-ja, "Njoftim për shuarjen vullnetare" të biznesit N.P.T."AMI-D" (DPKI-03-02-1289/15) duke shmangur kështu konfliktin e interesit në ushtrimin e funksionit publik.

II. Në pajtim me nenin 18 paragrafi 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit. Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtari i lartë publik
- Drejtorit të DPK-së
- Z./zpj. (zyrtari përgjegjës)
- Z./zpj. (zyrtari ndihmës)

Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit



/Hasan Pretenia/
[Handwritten signature over the stamp]